## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJGJEVE PËR VITIN 2025

Periudha (mars 2025)

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 07 | 03.03.2025 | 1.Sa është numri I personave në çdo njësi bashkiake/administrative që shërbejnë ndaj pakicave kombëtare?<br>2.Sa është buxheti qendror I alokuar për vitin 2025 për ta dhe buxheti që çdo NJVQV ka alokuar për vitin 2025?<br>3.Sa janë të përfaqësuara pakicat kombëtare në këshillat bashkiakë apo njësitë administrative?<br>4.Çdo informacion mbi gjendjen aktuale, si dhe planet konkrete për vitin 2025 për adresimin e angazhimeve të marra në kuadër të piketave të ndërmjetme? | 04.03.2025 | 1.Në Bashkinë Belsh dhe njësitë administrative nuk ka asnjë të punësuar që i shërben specifikisht pakicave kombëtare.<br>2.Nuk ka buxhet qendror të alokuar për vitin 2025 për këtë kategori, ashtu si dhe nuk ka buxhet të alokuar nga NJQV për këtë vit.<br>3.Komuniteti egjiptian është i përfaqësuar në Këshillin Bashkiak me një përfaqësues.<br>3.Për vitin 2025, në njësinë administrative Fierzë është i punësuar një individ nga ky komunitet.<br>4.Në njësinë administrative Belsh, janë të punësuar shtatë individë të komunitetit egjiptian për vitin 2025.<br>5.Aktualisht, tre familje egjiptiane janë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike për vitin 2025.<br>6.Nuk ka ende plane konkrete të hartuara për vitin 2025 për adresimin e angazhimeve të marra në kuadër të piketave të ndërmjetme. | E plotë | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 08 | 04.03.2025 | 1.A ka njësia juaj vendore pakica kombëtare mbi 20% të numrit të përgjithshëm të popullsisë? Nëse po, cilat nga këto pakica janë ato?<br>2.Çfarë masash keni marrë për të mundësuar përdorimin e gjuhës së pakicave kombëtare, ndërmjet personave që u përkasin këtyre pakicave dhe administrates tuaj, a ka kërkesa të tilla? Nëse ka, a janë marrë masa, dhe ju lutem ti specifikoni?<br>3.A ka vendime të organeve të njësisë suaj vendore për përdorimn e gjuhës së pakicave kombëtare, pɥr emërtimet topografike dhe dokumentacionin administrative? Nëse po, ju lutemi të na vini në dispozicion kopje të vendimeve përkatëse.<br>4.Çfarë masash janë ndërmarrë për përfshirjen e pakicave kombëtare në programet vendore? A ka vendime për këtë çështje? Nëse po, ju lutemi të na përcillni kopje të tyre.<br>5.A ka institucione arsimore që ofrojnë mësim në gjuhën e pakicave kombëtare në njësinë tuaj vendore/ Nëse po, cilat janë këto institucione dhe sa nxënës përfitojnë nga ky shërbim?<br>6.A ka programe të posaçme për strehimin e familjeve që i përkasin pakicave kombëtare? Nëse po, cilat janë dhe sa individë ose familje kanë përfituar? Ju lutem dërgoni kopjet e këtyre vendimeve. | 05.03.2025 | 1.Në Bashkinë Belsh, nuk ka pakica kombëtare që përbëjnë mbi 20% të numrit të përgjithshëm të popullsisë.<br>2.Nuk janë marrë masa për të mundësuar përdorimin e gjuhës së pakicave kombëtare dhe deri më tani nuk ka pasur kërkesa për këtë çështje.<br>3.Nuk kemi vendime administrative të miratuara nga organet e njësisë sonë vendore që lidhen me përdorimin e gjuhës së pakicave kombëtare.<br>4.Nuk ka vendime të miratuara për përfshirjen e pakicave kombëtare në programet vendore.<br>5.Në territorin e Bashkisë Belsh nuk ka institucione arsimore që ofrojnë mësim në gjuhën e pakicave kombëtare.<br>6.Tre familje që i përkasin pakicave kombëtare janë përfshirë në listën e miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë, vendim i cili i bashkëlidhet kësaj shkrese, për të përfituar mbështetje për bonus qiraje.<br>7.Tre familje të pakicave kombëtare janë përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike për vitin 2025. | E plotë | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 7.A ka skema të tjera, të veçanta mbështetjeje sociale për pakicat kombëtare në territorin tuaj? Nëse po, cilat janë këto masa dhe sa persona përfitojnë prej tyre? | | | | |
| 09 | 11.03.2025 | 1.Sa janë pagesat që keni kryer për inceneratorin e Elbasanit Eco –Elb për grumbullimin e mbetjeve për vitin 2022?<br>2.Kopjen e kontatës fillestare dhe ndryshimet që ka pasur pas kësaj date nëse ka pasur?<br>3.Sa janë pagesat që keni kryer për inceneratorin e Elbasanit Eco –Elb për grumbullimin e mbetjeve 2023?<br>4.Kopjen e kontratës fillestare dhe ndryshimet që ka pasur pas kësaj date nëse ka pasur?<br>5.Sa janë pagesat që keni kryer për inceneratorin e Elbasanit Eco –Elb për grumbullimin e mbetjeve 2024?<br>6.Kopjen e kontratës fillestare dhe ndryshimet që ka pasur pas kësaj date nëse ka pasur? | 26.03.2025 | 1.Pagesat që janë kryer nga viti 2022-2025:<br>- për vitin 2022 janë paguar 3 752 640 lekë,<br>-për vitin 2023 janë paguar 6 184 440 lekë,<br>-për vitin 2024 janë paguar 6 420 960 lekë,<br>-për vitin 2025 janë paguar 875 100 lekë.<br>2.Kopjet e kontratave fillestare me “ECO-ELB” sh.a, nga viti 2022-2025.<br>Kontrata Belsh-ECO-ELB 2022.pdf<br>Kontrata Belsh-ECO-ELB 2023.pdf<br>Kontrata Belsh-ECO-ELB 2024.pdf<br>Kontrata Belsh- ECO-ELB 2025.pdf<br>3.në territorin e bashkisë Belsh, ndodhen:<br>-Fusha e Kompostimit ku grumbullohen dhe trajtohen mbetjet e gjelbërta edhe kartonët.<br>-Venddepozitimi i inerteve, në vendin e ish- | E plotë | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 7.Sa janë pagesat që keni kryer për inceneratorin e Elbasanit Eco –Elb për grumbullimin dhe dërgimin e mbetjeve 2025?<br>8.Kopjen e kontratës fillestare dhe ndryshimet që ka pasur pas kësaj date nëse ka pasur?<br>9.Cilat janë pikat e landfillit në Bashkinë tuaj? | | Repartit Ushtarak në fshatin Trojas/Belsh,<br>-Ndërsa mbetjet e tjera urbane, mblidhen dhe transportohen direkt në “Impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit” sipas kontratës së lidhur midis Bashkisë Belsh dhe “ECO-ELB” sh.a.. | | |
| 10 | 11.03.2025 | 1.Cili është statusi aktual i krijimit të Strukturës së Diasporës dhe Migracionit (SDM) në bashkinë tuaj?<br>2.Si është formalizuar procesi i ngritjes dhe funksionimit të Strukturave të Diasporës dhe Migracionit në bashkinë tuaj?<br>3.Ju lutemi specifikoni drejtorinë, sektorin ose specialistin përgjegjës për çështjet e Migracionit dhe Diasporës bazuar në strukturën organizative të Bashkisë?<br>4.Nëse SDM nuk është krijuar ende ose është pjesërisht e krijuar, cila është arsyeja?<br>5.Nëse Strukturat e Diasporës dhe Migracionit (SDM) janë plotësisht ose pjesërisht të krijuara, sa anëtarë stafi janë caktuar për SDM?<br>Ju lutemi jepni numrin e saktë?<br>6. Nëse Strukturat e Diasporës dhe Migracionit (SDM) janë plotësisht ose pjesërisht të krijuara, jepni informacion mbi stafin e caktuar për SDM: (Mund | 12.03.2025 | 1. Nuk është krijuar ende si strukturë.<br>2. Nuk është ngritur strukturë.<br>3. Paolina Rusta - Specialiste e Sektorit të Projekteve dhe Be.<br>4. Mungesë Ekspertize dhe staf i pa trajnuar në çështjet e migracionit dhe diasporës dhe Sfida Administrative: Vonesa në krijimin e strukturave.<br>5. 1 person i deleguar.<br>6. Ky rol i është deleguar një specialisti që ka një rol tjetër funksional në bashki.<br>7. Nuk jam i sigurt / Nuk e di.<br>8. Asnjë nga shërbimet.<br>9. Disa trajnime janë të nevojshme dhe Rritja e mëtejshme e kapaciteteve është shumë e nevojshme.<br>10. Korniza Ligjore, Institucionale dhe Politikat mbi menaxhimin e migracionit, Menaxhimi dhe Analiza e të Dhënave, Ndërtimi i Networkut dhe Partneriteteve, Ofrimi i Shërbimeve dhe Mekanizmat e Referimit, Integrimi i Perspektivës | E plotë | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të zgjidhni më shumë se një alternativë)?<br>7.Nëse Strukturat e Diasporës dhe Migracionit (SDM) janë plotësisht ose pjesërisht të krijuara, ju lutemi jepni një shpjegim nëse përshkrimi i punës dhe përgjegjësitë e stafit të caktuar janë të përcaktuara në rregulloren bashkiake ose rregullore të tjera të brendshme?<br>8.Nëse Strukturat e Migracionit dhe Diasporës (MDS) janë plotësisht ose pjesërisht të krijuara, cilat procedura dhe shërbime ofrohen nga MDS?<br>9.Cilat janë nevojat për kapacitete dhe trajnime për stafin e Strukturat e Diasporës dhe Migracionit (SDM)?<br>10.Nëse trajnimet për stafin e MDS janë të nevojshme, cilat janë temat relevante për rritjen e kapaciteteve?<br>11.Cili është pozicioni i personit të kontaktit në bashkinë tuaj për Rrjetin Lokal mbi Migracionin (LNM)?<br>Pozicioni (Kryetar Bashkie, Nënkryetar Bashkie, Shef Kabineti, Anëtar i Këshillit Bashkiak, Tjetër?<br>12.Cilat janë nevojat për rritjen e kapaciteteve ose orientimin e personit të kontaktit?<br>13.Cilat janë temat relevante që duhet të përfshihen për rritjen e kapaciteteve për stafin e | | Gjinore në Menaxhimin e Migracionit.<br>11. Tjetër: Specialist i Zyrës së Projekteve dhe BE<br>Arsimi: I Lartë<br>Vitet e Eksperiencës në Punë:2<br>12. Nevojë për trajnim të konsiderueshëm.<br>13. Korniza Ligjore, Institucionale dhe Politikat mbi Menaxhimin e Migracionit, Menaxhimi dhe Analiza e të Dhënave, Ndërtimi i Networkut dhe Partneriteteve, Ofrimi i Shërbimeve dhe Mekanizmat e Referimit, Integrimi i Perspektivës Gjinore në Menaxhimi i Migracioni.<br>14. Laptop, Printer dhe skaner, Software.<br>Mobilimi dhe Materialet e Zyrës: Materiale dhe pajisje zyre.<br>Mjetet e Komunikimit: Smartphone dhe tabletë, Pajisje për video-konferenca.<br>15.Pozita/Drejtoria/Sektori: Sektori i Projekteve dhe BE<br>Fusha e Arsimit: Menaxhim Turizmi Rural<br>Vitet e Eksperiencës në Punë: 2. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | SDM, nëse kërkohet trajnim?<br>*14.*Cilat janë nevojat për pajisje për strukturat e migracionit dhe diasporës në bashkinë tuaj?<br>Pajisjet Kompjuterike dhe IT?<br>15.Kush është personi i kontaktit për Strukturën e Migracionit dhe Diasporës (në bashkinë tuaj në nivel politik, administrativ dhe teknik? | | | | |
| 11 | 13.03.2025 | 1.A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse (OJF) gjatë vitit 2024?<br>2.Nëse keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qenë forma e mbђshtetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurorim publik/tenderim, etj.)?<br>3.Sa OJF kanë aplikuar për mbështetje financiare gjatë vitit 2024? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes, nëse ka patur më shumë se një formë.<br>4. Sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes, nëse ka patur më shumë se një formë.<br>5.Cili ka qenë buxheti I disbursuar për organizatë dhe në total? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes, nëse ka patur më shumë se një formë.<br>6.Keni ofruar mbështetje jofinanciare gjatë vitit 2024? Cila është baza | 27.03.2025 | 1.Po, kemi ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse (OJF) gjatë vitit 2024.<br>2.Forma e mbështetjes financiare që është ofruar ka qenë në formën e grantit.<br>3.Gjatë vitit 2024 kanë aplikuar dy OJF për mbështetje financiare, në formën e grantit.<br>4.Nga kjo mbështetje kanë përfituar dy OJF, në formën e grantit.<br>5.Buxheti i disbursuar ka qenë:<br>- Shoqata për Autonomi Vendore 323.000 lekë<br>- Forumi i Gruas 200.000 lekë<br>- Totali 523.000<br>6.Po, bashkia Belsh ka ofruar mbështetje jofinanciare gjatë vitit 2024, konkretisht, për Forumin e Gruas Elbasan dhe gjithashtu për Qendrën Shqiptare për Integrimin e Njerëzve me Nevoja të Veçanta lidhur me projektin me titull "Çelsi i Harmonisë", projekt i cili ka filluar në vitin 2023 dhe ka përfunduar në vitin 2024. Baza ligjore | E plotë | Pa pagesë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ligjore/rregullatore që rregullon këtë formë mbështetjeje?<br>7.Nëse keni ofruar mbështetje jofinanciare, sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Cili ka qenë lloji i mbështetjes jofinanciare të ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj.)?<br>8.Sa është numri i konsultimeve publike të realizuara nga institucioni juaj gjatë vitit 2024?<br>9.A ka institucioni juaj koordinator për njftimin dhe konsultimin publik? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin.<br>10.A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin.<br>11.Sa OJF kanë marrë pjesë në konsultime publike të organizuara nga institucioni juaj?<br>12.Sa % e projektligjeve/akteve nënligjore të hartuara nga institucioni juaj janë si rezultat i konsultimeve me OJF-të?<br>13.A janë të përfshirë përfaqësues të OJF-ve në organe këshillimore të institucionit tuaj? Nëse po, cilat janë këto organe këshillimore dhe sa OJF janë të përfshira në to?<br>14.A janë përfshirë OJF në grupet e punës të ngritura të institucionit tuaj? Nëse po, cilat janë këto grupe pune dhe sa OJF janë të perfshirë në to? | | /rregullatore që rregullon këtë formë mbështetjeje është, ligji nr.139 datë 17.12.2015 " *Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar.<br>7.Mbështetje jofinanciare kanë përfituar dy OJF të cilat janë përmendur më sipër. Mbështetja jofinanciare që i është dhënë këtyre OJF-ve ka konsistuar në vënien në përdorim nga ana e tyre të mjediseve të Bashkisë për takime dhe trajnime të ndryshme, në ndarjen e eksperiencave etj..<br>8.Gjatë vitit 2024 janë realizuar katër konsultime publike.<br>9.Fatmira Broshka, Koordinatore për të Drejtën e Informimit dhe Konsultim Publik.<br>Email; fatmira.broshka@bashkiabelsh.gov.al<br>10.Institucioni jonë nuk ka një Koordinator për Shoqërinë Civile.<br>11.Gjatë vitit 2024 asnjë OJF nuk ka marrë pjesë në konsultimet publike që janë organizuar.<br>12.Po, ka pasur projektligje/akte nënligjore të hartuara nga institucioni jonë si rezultat I konsultimeve me OJF-të, por nuk kemi një databazë me të dhëna të sakta.<br>13.Po, është e përfshirë një OJF në Komisionin Këshillimor pranë Kryetarit të Bashkisë.<br>14.Në grupet e punës të ngritura në institucion, nuk ka OJF të përfshira. | | |